

# Çështje etike të fotografisë së medias

Rrapo Zguri\*

## Abstrakt

Syri nuk gënjen. Aparatet fotografike bazohen në besnikërinë e syrit. Rrjedhimisht ato nuk gënjejnë (camera never lies – kamera nuk gënjen kurrë). Për vite e dekada me radhë fotografët e medias e kanë pasur si mburojë dhe argument të parë këtë tipologji arsytimi që lidhet me debatin e hershëm rreth raporteve të këtij mediumi vizual me të vërtetën objektive.

Duke thjeshtëzuar analizën teorike-filozofike, çështja shtrohet: fotografia është një pasqyrim objektiv i realitetit apo është një lloj informacioni vizual i cili është i ndikuar nga subjektiviteti i autorit të saj? Ç'rol kanë bindjet, pikëpamjet, stereotipat, paragjykimet, interesat, përkatësia individuale apo shijet e autorit të një fotografie në krijimin e produktit final?

Trajtesa e mëposhtme synon të hedhë dritë mbi raportet e fotografisë së medias me të vërtetën objektive, duke u ndalur në debatin teorik në këtë fushë. Një vend të konsiderueshëm zë analiza e problemeve etike të fotogazetarisë në Shqipëri si dhe roli i digjitalizimit të medias dhe i internetit në amplifikimin e këtyre problemeve. Pas vështrimit panoramik dhe të detajuar, vijnë edhe konkluzionet dhe rekomandimet që do t'i shërbejnë praktikës së fotogazetarisë për të minimizuar shkeljet etike përmes ndërtimit të një kornize vetërregulluese dhe një politike editoriale efektive dhe transparente.

*Fjalë kyçe: media vizuale, e vërteta objektive, interpretimi i realitetit, fotogazetaria, etika, fotografia pasqyrë, fotografia dritare, korniza vetërregulluese, politika editoriale*

---

\* Rrapo Zguri, PHD candidate, Departamenti i Gazetarisë dhe i Komunikimit, Universiteti i Tiranës

## Hyrje

A është fotografia (përfshi këtu edhe fotografinë e medias) një pasqyrim apo një interpretim i realitetit? Arthur Berger në "Seeing is believing" është kategorik në përgjigjen e vet: "Një foto është gjithnjë një interpretim i realitetit, jo realiteti vetë".<sup>1</sup>

Shumica e autorëve që merren me studimin e fotografisë janë në një linjë me Arthur Berger, kur bie fjala për raportin e fotografisë me realitetin. Terence Wright thekson se "interpretimi (i realitetit –shënim i autorit) duket të jetë termi më i përafërt i përdorur për të shprehur kuptimin tonë mbi fotografinë".<sup>2</sup> Ndërsa për Kenneth Kobre "fotografia është një njohje simultane në një fraksion të sekondës e rëndësisë së një eventi si dhe një organizim i saktë i formave që i japin një eventit paraqitjen e duhur".<sup>3</sup>

Po qe se do t'i referoheshim përvojës së medieeve shqiptare, por edhe atyre botërore do të konstatojmë se ka shumë raste kur fotografitë e medieeve, edhe kur janë të paprekura, janë të ndikuara nga subjektiviteti i autorit. Për Daniel R. Bersak "Etika e fotogazetarisë duhet të marrë parasysh edhe zgjedhjet individuale të fotografit në çastin kur ai shkrep aparatën fotografik".<sup>4</sup>

## Raporti i fotografisë me realitetin

Në mediet shqiptare ka ndodhur që e njëjta ngjarje të vijë me dy pamje të ndryshme. Për shembull, kur bën një foto të mitingut të qeverisë, fotografi i një gazete pro-qeveritare gjen një kënd të tillë fotografimi që të krijon përshtypjen se pjesëmarrja ka qenë shumë e

---

<sup>1</sup> Arthur Asa Berger, *Seeing is believing: an introduction to visual communication*, McGraw Hill Education, 2007, f. 13

<sup>2</sup> Terence Wright, *The Photography Handbook*, Routledge, London and New York, 2003, f.6

<sup>3</sup> Kenneth Kobre, *Photojournalism: The Professionals' Approach*, Taylor & Francis, 2004, f. 27

<sup>4</sup> Daniel R. Bersak, *Ethics in Photojournalism: Past, Present, and Future*, Massachusetts Institute of Technology, Department of Comparative Media Studies, 2006, website: <http://web.mit.edu/drj/Public/PhotoThesis/>

madhe. Nga ana tjetër, fotografi i një gazete pro-opozitare gjen një kënd fotografimi që të krijon përshtypjen se pjesëmarrja ka qenë shumë e vogël. Edhe pse është fotografuar i njëjti event, mesazhi i përcjellë përmes fotografisë lidhur me pjesëmarrjen është i ndryshëm, shpesh i kundërt. Në raste të tjera, një personazh, një statujë apo një ndërtesë e ulët, e fotografuar nga poshtë dhe sa më afër bazës mund të duket gjigante në fotografi, duke cenuar apo deformuar pamjen reale. Krijimi i iluzioneve apo i perceptimeve optike të ndryshme bëhet shpesh edhe pjesë e lojës politike. Kjo ndodh për shkakun se mesazhi i përcjellë është i ndikuar nga bindjet personale dhe/ose politika editoriale e medias ku punon fotografi që ka bërë këtë foto.

Studiues të fotografisë së medias kanë konstatuar se stereotipet dhe paragjykimet (që janë të pranishme diku më pak e diku më shumë te pothuajse çdo njeri), kanë një ndikim të madh në vendimmarrjen dhe procesin e të fotografuarit.<sup>5</sup> Ndodh shpeshherë që pamjet nga vende apo ngjarje të ndryshme të mos pasqyrojnë realitetin e përgjithshëm por të jenë reflektim i stereotipeve dhe paragjytimeve të autorit të fotografisë. Ka pasur raste, për shembull, kur shkrimet për Shqipërinë në mediet e huaja janë shoqëruar me fotografi ku paraqiten gra që kërcëjnë belly-dancing apo që janë të mbuluara tërësisht me perçe. Në këto raste stereotipet krijojnë një imazh që nuk përputhet me realitetin. Për fat të mirë media shqiptare në përgjithësi është e kujdesshme kur zgjedh pamjet që shoqërojnë lajmet nga vendet e tjera, ndërsa e kundërta ndodh rrallë. Megjithatë, edhe në mediet shqiptare nuk mungojnë imazhet paragjykuese ndaj komuniteteve të veçanta, ndaj minoriteteve etnike, gjuhësore, seksuale, etj.

Me zhvillimin e teknologjisë janë shtuar edhe mjetet apo aksesoret që kontribuojnë në tjetërsimin e realitetit të fiksuar në fotografi. Kamerat e sotme përmbajnë një numër të madh lentash apo filtrash përmes të cilave mund të deformohet apo të ndryshohet lehtësisht pamja gjatë fotografimit apo filmimit.

---

<sup>5</sup> Paul Lester, *Photojournalism: An Ethical Approach*, Lawrence Erlbaum Associates, Incorporated, 1991, f. 134

Lidhur me këtë situatë, Steve Larson, drejtor fotografie në US & World News Report, thotë: “Fotografia është regjistrim i një momenti real. Ne nuk bëjmë mirë kur përpiqemi ta ndryshojmë këtë. Duhet ta ruajmë këtë pakt. Këtu qëndron forca e fotografisë”. Qysh herët, studiuesit e fotografisë kanë paralajmëruar dëmin që mund t’i sjellë fotografisë së medias shmangia nga e vërteta. Në librin e tij të mirënjohur *Truth Needs No Ally: Inside Photojournalism*, Howard Chapnick thekson: “Besueshmëri. Përgjegjshmëri. Këto fjalë na japin ne të drejtën ta quajmë fotografinë një profesion dhe jo një biznes. Rënia e besueshmërisë do të shkatërrojë impaktin tonë gazetaresk, respektin për veten si dhe rëndësinë e fotografisë si komunikim”.<sup>6</sup>

Jo rrallë fotografia e medias është akuzuar për rikrijim të realitetit. Në vitet ’30-të të shekullit të kaluar, në kohën e Depresionit të Madh në SHBA, u hap debati lidhur me dukurinë që njihet me emrin “parapërgatitje e skenës”. Fotografët nuk fotografonin të varfëritë apo lypsarët nëpër rrugë ashtu siç ishin në realitet, por i vendosnin në pozicione të tilla që të krijonin një imazh edhe më të rëndë të krizës. Debati u shtri më tej mes koncepteve të “fotografisë pasqyrë” dhe “fotografisë dritare”, që lidhej me raportin që duhet të mbante fotografia ndaj realitetit.<sup>7</sup> Në medien shqiptare dukuria e rikrijimit të realitetit apo e “parapërgatitjes së skenës” shfaqet në forma të ndryshme. Për shembull, shpesh intervistat me personalitete apo njerëz të njohur shoqërohen me fotografi të tyre të bëra jo në jetën reale por në studio fotografike, ku është bërë kujdes që të hiqet ndonjë nishan apo rrudhë, të përafrohet ngjyra e make-up-it me ngjyrën e syve apo të veshjes, etj. Dhe më keq akoma, këto fotografi “artistike” mund të jenë bërë edhe nga vetë fotografët e gazetës apo revistës ku botohet intervista përkatëse. Ndeshen shpesh edhe raste kur politikanët apo zëdhënësit, pasi bëjnë gati gjithçka, u thonë fotografëve apo kameramanëve: “Gati?” (Say cheese, please). Pra, skena është gati. Tani mund të fotografoni apo të filmoni skenën, siç e kanë rregulluar partitë politike.

---

<sup>6</sup> Howard Chapnick, *Truth Needs No Ally: Inside Photojournalism*, University of Missouri, 1982, f. 41-42

<sup>7</sup> Victor Burgin, *Thinking Photography*, Macmillan, London, 1982, f. 44

Probleme të mëdha etike vihen re sidomos në fazën “post-produksion”, kur ndeshen jo rrallë raste të manipulimit të fotografive ekzistuese. Në fakt manipulimi apo retushimi i fotografisë është i hershëm dhe është aplikuar edhe përpara epokës së digjitalizimit. Është i mirënjohur rasti i fotografisë së Abraham Lincoln të botuar në një gazetë amerikane në fillim të shekullit të kaluar, e cila bëri bujë pasi u zbulua se në foto vetëm koka ishte e Lincoln-it, kurse trupi ishte i marrë nga një foto tjetër dhe i përkiste senatorit John C. Calhoun. Veçanërisht në regjimet autoritariste dhe diktatoriale, manipulimi i fotografive u kthye në një praktikë të rëndomtë. Fotografitë e manipuluar të Leninit, Stalinit, Enver Hoxhës, etj. ishin të panumërta. Por edhe sot nuk mungojnë rastet kur fotografi të takimeve të rastësishme jo formale të liderëve shqiptarë me personalitete të huaja nëpër korridore hotelesh, paraqiten si fotografi takimesh zyrtare.

Një nga rastet më të bujshme të manipulimit në fotografinë profesioniste të viteve të fundit është ai i fotografit, Brian Walski i L.A. Times në SHBA, i cili u pushua nga puna kur u mësua se kishte botuar një fotografi të montuar nga lufta në Irak. Atij iu hoq edhe një çmim që kishte marrë për këtë fotografi nga shoqata e fotografëve profesionistë të medias. Walski përmes montimit krijoi prej dy fotografive një fotografi të tretë.<sup>8</sup> (Shihni imazhet – fotografia sipër është krijuar nga montimi i dy fotografive më poshtë)

---

<sup>8</sup> Daniel R. Bersak , *Ethics in Photojournalism: Past, Present, and Future* , Massachusetts Institute of Technology, Department of Comparative Media Studies, 2006, website: <http://web.mit.edu/drb/Public/PhotoThesis/>



Me digjitalizimin e fotografisë dhe krijimin e programeve kompjuterike për përpunimin e saj, mundësia për manipulim është rritur më tej dhe në shumë raste është e vështirë që të konstatohet. Interneti në vetvete e amplifikoi shpërndarjen e fotografive të manipuluar. Termi “photoshop-im” ka hyrë tashmë në të gjitha gjuhët e botës, madje edhe në shqip, duke nënkuptuar tjetërsimet apo ndërhyrjet e bëra në një fotografi përmes programit Photoshop. Mjaft operacione digjitale manipuluese që bëhen përmes programeve kompjuterike, konsiderohen si shkelje të etikës nga shumica e kodeve të etikës së fotografisë në vende të ndryshme. Ja një pjesë e këtyre shkeljeve etike:

- Shtimi, heqja apo zhvendosja e objekteve të fotografisë, sidomos kur kjo gjë tjetëron kontekstin e ngjarjes

- Ndryshimi i shprehjes së fytyrës, gjesteve, veshjes, pjesëve trupore ose të aksesorëve personalë

- Tjetërsimi i moshës – paraqitja e një personi si më i ri ose më i plakur

- Retushimi që mbivlerëson apo nënçmon cilësinë apo kërkesën për një produkt dhe tjetërsimi estetik i një mjedisi

- Ndryshimi i ngjyrave në masë të tillë që i largohen ngjyrave origjinale

- Përdorimi i efekteve apo teknikave digjitale që japin një përshtypje të gabuar apo të deformuar mbi ngjarjet, pjesëmarrësit apo kontekstin

- Heqja e elementëve të autenticitetit apo të autorësisë (vula, nënshkrime, logo, emri i autorit, emri i studios, etj.)

- Prerja e fragmenteve të dëmtuara, kur kjo cenon kontekstin apo objektivitetin e pamjes.<sup>9</sup>

Natyrisht jo çdo lloj operacioni digjital konsiderohet shkelje e etikës. Për shembull, operacionet kompjuterike që lidhen me përmirësimin apo restaurimin e objektivitetit apo saktësisë së imazhit, jo vetëm që nuk konsiderohen si shkelje etike por janë të rekomanduara të kryhen. Të tilla janë: balancimi i ngjyrave, korrektimi i dëmtimit prej lenteve, optimizimi i imazhit, axhustimi i fokusit, eliminimi i refleksëve të diellit apo dritës, optimizimi i përgjithshëm i ndriçimit, eliminimi i efektit të syrit të kuq, etj. Gjithashtu mund të bëhet edhe prerja e imazhit kur kjo nuk ndryshon kontekstin, nxjerrja në pah e një pjese të imazhit kur kjo shërben për qëllime investigimi, mbulimi i identitetit të individëve kur kjo rekomandohet ose kërkohet ligjërisht, etj.<sup>10</sup>

Probleme të tjera të etikës së fotografisë së medias janë ato që lidhen me cenimin e privatësisë. Pas viteve '90-të paparacia dhe paparacët nuk munguan të shfaqen edhe në Shqipëri. Ndërkohë gazetat dhe revistat, duke u thelluar në tabloidizimin e tyre, i shtuan faqet e lajmit rozë dhe ato të skandalit. Disa nga problemet etike në raport me privatësinë që janë vënë re në mediet shqiptare janë: fotografimi apo filmimi në hapësirën dhe jetën private të personave publikë, si politikanë, artistë, këngëtarë, etj., publikimi i fotove të personave të mitur, të dhunuar apo të masakruar si dhe i fotove të viktimit të prostitucionit, deformimi i imazhit të një personi apo

---

<sup>9</sup>*DigitalCustom Model Ethics Guidelines*, website: <http://digitalcustom.com/howto/mediaguidelines.asp>

<sup>10</sup> *DigitalCustom Model Ethics Guidelines*, website: <http://digitalcustom.com/howto/mediaguidelines.asp>

vënia e tij nën një dritë të rreme, përvetësimi i imazhit të një individi për qëllime të ndryshme, etj.

Të shpeshta janë edhe rastet e shkeljes së të drejtës së autorit, duke publikuar fotografi pa marrë më parë miratimin dhe pa e shpërblyer autorin e fotografisë. Gjuetia që bëhet në internet ndaj fotografisë dhe asgjësimi përmes klikimit djathtas, ka krijuar një radhë problemesh etike që kërkon përgjigje dhe zgjidhje konkrete. Natyrisht rekomandimi më i mirë në këtë rast, përkrah forcimit të legjislacionit, do të ishte aplikimi i vetë rregullimit në vend të vetë shkatërrimit. Krijimi i kodeve të etikës edhe për fotografinë e medias, hartimi i manualeve apo i rregulloreve për përpunimin digjital të fotografisë, mund të ndihmonin shumë në këtë aspekt.

### ***Përfundime***

Pavarësisht se përfaqëson një aspekt vizual të një skene ngjarjeje në një moment të dhënë, fotografia e medias mbetet në të vërtetë një interpretim i realitetit. Ajo është e ndikuar në një masë të madhe nga subjektiviteti i autorit të saj, nga bindjet, pikëpamjet, stereotipet, paragjykimet, interesat, përkatësia individuale apo shijet e tij. Një ndikim të madh kanë edhe politikat editoriale të medieve të ndryshme. Kjo lloj varësie e fotografisë së medias nga faktorë subjektivë, ndikon jo vetëm në raportet e saj me të vërtetën objektive, por bëhet shkak edhe për lindjen e një morie problemesh etike, siç janë deformimi i realitetit për qëllime të ndryshme, (sidomos politike), vënia e ngjarjeve nën një dritë të rreme, cenimi i imazhit të personave të ndryshëm publikë ose jopublikë, ndërhyrja në jetën private ose në territorin privat të tjetrit, cenimi i të drejtës së autorit, etj.

Në Shqipëri, edhe pse për gazetarinë në përgjithësi janë hartuar kode të etikës, për fotografinë e medias nuk ka ende një kornizë vetërregulluese. Organizatat e fotoreporterëve të medias janë pothuajse inekzistente. Ndërkohë digjitalizimi i medias dhe përhapja masive e internetit e kanë shtuar gamën e problematikës etike dhe kanë bërë urgjente nevojën e trajtimit më të thelluar teorik, si dhe gjetjen e zgjidhjeve konkrete praktike për minimizimin e rasteve të shkeljeve të etikës.



## ***Bibliografi***

Arthur Asa Berger, *Seeing is believing: an introduction to visual communication*, McGraw Hill Education, 2007 .

Howard Chapnick, *Truth Needs No Ally: Inside Photojournalism*, University of Missouri, 1982

Kenneth Kobre, *Photojournalism: The Professionals' Approach*, Taylor & Francis, 2004

Martin Lister, *The Photographic Image in Digital Culture*, Routledge, London, 1995

Paul Lester, *Photojournalism: An Ethical Approach*, Lawrence Erlbaum Associates, Incorporated, 1991

Terence Wright, *The Photography Handbook*, Routledge, London and New York, 2003

Victor Burgin, *Thinking Photography*, Macmillan, London, 1982

## ***Webliografi***

*DigitalCustom Model Ethics Guidelines*, website:  
<http://digitalcustom.com/howto/mediaguidelines.asp>

Daniel R. Bersak , *Ethics in Photojournalism: Past, Present, and Future*, Massachusetts Institute of Technology, Department of Comparative Media Studies, 2006, website: <http://web.mit.edu/drbr/Public/PhotoThesis/>